

PLANI I VEPRIMIT 2018

**PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIMIN E STRATEGJISE KOMBETARE TE DIASPORES
PER PERIUDHEN 2018**

Nr.	Masa	Institucioni Pergjegjes	Afati
I	KRIJIMI I NJE KUADRI TE PLOTE TE POLITIKBERJES MBI DIASPOREN		
1	Bërja funksionale e institucioneve që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me Diasporën siç janë AKD, Fondi për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën. Hartimi i një plani të detajuar për përthithjen e fondeve të nevojshme për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare. Ndarja e qartë e kompetencave midis strukturave që do të merren me trajtimin e diasporës. Krijimi i një njësie të specializuar për rishikimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.	Zv/ Kryeministri MSHD MFE	6 maji parë 2018 (periodike)
2	Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin.	MSHD MK MASR MSHMS	6 maji dytë 2018 (periodike)
3	Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2024.	MFE MASR MK MSHD	6 maji dytë 2018 (periodike)
4	Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të Diasporës si ngjarja e më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare, me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të shqyrtohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet në Shqipëri.	MSHD MEPJ MFE MASR	6 maji parë 2018 (periodike)
5	Krijimi i Këshillit Koordinativ të Diasporës si një strukturë koordinative për të punuar për forcimin organizativ të e komuniteteve shqiptare me qëllim përfshirjen dhe partneritetin në zhvillimin e Shqipërisë.	MSHD MEPJ	6 maji dytë 2018

6	Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani veprimi të veçantë për nxitjen e organizimit në nivel rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse. Promovimi i idesë për mbajtjen e aktiviteteve që nxisin këtë nivel organizimi nëpërmjet informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.	MSHD MEPJ MASR MK	6 maji dytë 2018 (periodike)
7	Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës për fushën e marrëdhënieve me diasporën në funksion dhe për pasurimin e marrëveshjeve ekzistuese që ekzistojnë midis dy vendeve në këtë drejtim. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe "prodhuese" të diasporave shqiptare në botë.	MEPJ MASR MSHD	6 maji dytë 2018
10	Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor në vendet me një prezencë të qenësishme të komuniteteve shqiptare dhe të një rëndësie të veçantë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve diplomatike dhe ekonomike të vendit pritës me vendin e origjinës. Orientimi i planit të punës së trupës diplomatike dhe konsullore me një fokus të veçantë drejt marrëdhënieve me komunitete shqiptare jashtë vendit.	MEPJ MSHD	6 maji dytë 2018
13	Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur. Organizimi i aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit.	Zv/Kryeministri MEPJ MB MSHD	6 maji dytë 2018 (periodike)
15	Mundësimi i informacioneve rreth diasporës shqiptare dhe zhvillimin e komuniteteve jashtë vendit. Realizimi i një raporti vjetor ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën.	MEPJ MSHD MASR INSTAT	6 maji dytë 2018 (periodike)

16	Realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta për fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil.	Zv/Kryeministri MEPJ MSHD MASR MD	6 maji dytë 2018 (periodike)
19	Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për Migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.	Zv/Kryeministri MEPJ MB MSHD MD	6 maji dytë 2018 (periodike)
20	Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.	MEPJ MSHD - AKD MD	6 maji dytë 2018
21	Nxitja dhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende. Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës.	MEPJ MSHD - AKD MSH MD	6 maji dytë 2018 (periodike)
23	Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë).	MEPJ MSHD MFE MSH MD	6 maji dytë 2018 (periodike)

//	KRIJIMI I NJE INSTRUMENTI TE DOBISHEM NE NDIHME TE QEVERISE DHE AKTOR-EVE TE TJERE PER TE PERMIRESUAR DHE FUQIZUAR BASHKEPUNIMIN ME DIASPOREN DHE MIGRACIONIN E LIGJSHEM		
39	Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime “ad hoc” për emigrantët (brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit).	MFE MSHD MSHMS	6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)
40	Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.	MEPJ MASR MK MSHD Akademia e Shkencave	6 maji dytë 2018 (periodike)
45	Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo “Ditëve të Shqipërisë” në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.	MEPJ MSHD MK MTM MIE MSHMS	6 maji dytë 2018 (periodike)
///	PERGATITJA E ADMINISTRATES PER NIVELIN E RI TE MARREDHENIES TE POLITIKES SHTETERORE ME DIASPOREN		
47	Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional për ta nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje.	MFE MIE MSHD MSHMS MBZHR MTM	6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)
48	MEPJ përmes strukturave të saj të diplomacisë ekonomike do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me diasporën shqiptare në botë për shfrytëzimin e potencialit ekonomik që kjo diasporë mbart në vetvete, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktivitësh vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë me njëri-tjetrin dhe vendlindjen.	MEPJ MFE MIE MSHD MSHMS	6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)

51	Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërore për informacionin të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me “kujdestarët” e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.	MSHD MEPJ AKSHI	6 maji dytë 2018 (periodike)
56	Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit i aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.	MK MEPJ MSHD	6 maji dytë 2018
59	Vlerësimi vjetor i nevojave për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësim periodik i kurikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurikulave të përbashkëta.	MSHD MASR MEPJ	6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)
62	Zhvillimi i projektit “e-book” (shkarkimi online i teksteve shkollor të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.	MSHD MASR MEPJ Akademia e Shkencave	6 maji dytë 2018
63	Rishikimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse). Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende.	MSHD MEPJ MASR	6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)

64	Rishikimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Vlerësimi i kryerjes së një studimi të thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen.	MSHD MEPJ MASR	6 mujori dytë 2018 (periodike çdo vit)
66	Promovimi i programeve apo donatorëve të cilët ofrojnë bursa për studime jashtë vendit, për Shqipërinë. Organizimi i aktiviteteve për informimin në shkollat e mesme dhe të larta me qëllim njohjen e këtyre programeve dhe procedurave të aplikimit si nga pedagogët, studentët apo nxënësit.	MSHD MEPJ MASR	6 mujori dytë 2018 (periodike çdo vit)
68	Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV e migrantëve të kualifikuar.	MSHD MEPJ MB MFE MIE MASR	6 mujori dytë 2018 (periodike çdo vit)
MONITORIMI			
71	Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit në Samitin e Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme.	MSHD MEPJ	6 mujori dytë 2018 (periodike)